

VENDIM
Nr. 322, datë 6.5.2026

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE
TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (PERF)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (në vijim “PERF”).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore PERF është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

3. Të dhënat e bazës së të dhënave shtetërore PERF ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura dhe të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me subjektet raportuese, që kanë të bëjnë me:

- i. raportet financiare vjetore të partive politike;
- ii. raportet financiare të fushatave zgjedhore;
- iii. të dhënat për burimet e financimit, përfshirë financimet publike dhe jopublike;
- iv. të dhënat për shpenzimet e kryera gjatë fushatës zgjedhore dhe jashtë saj;
- v. të dhënat për dhurimet monetare dhe dhurimet në natyrë;
- vi. të dhënat për huat dhe kreditë;
- vii. dokumentacionin financiar dhe administrativ shoqërues;
- viii. raportet e monitorimit financiar dhe raportet e auditimit;
- ix. vendimmarrjen administrative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me kontrollin, verifikimin dhe auditimin e financimeve të subjekteve politike e zgjedhore.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera shtetërore, vetëm në masën e nevojshme për identifikim, si më poshtë vijon:

i. Të dhëna të përgjithshme të subjektit politik, si person juridik, koalicionet dhe subjekteve zgjedhore nga baza e të dhënave shtetërore “Tatimi elektronik”, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

ii. Të dhënat personale të individëve të deklaruar si kandidatë për deputetë, kandidatë për kryetar bashkie, financierë të partive politike, auditues ligjorë dhe monitorues të fushatës zgjedhore nga baza e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

4. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore PERF janë partitë politike, koalicionet, subjektet zgjedhore, kandidatët, financierët, audituesit ligjorë, si dhe institucionet publike, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar.

5. Baza e të dhënave shtetërore e Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF) ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, të

administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dhe me bazën e të dhënave “Tatimi elektronik”, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për qëllime identifikimi dhe verifikimi të të dhënave personale të personave fizikë, të përfshirë në procesin e raportimit financiar.

6. Përpunimi i të dhënave personale në PERF kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Të dhënat personale të transmetuara dhe të përpunuara në bazën e të dhënave shtetërore PERF ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të këtij afati, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen, sipas procedurave të institucionit administruar.

8. Niveli i aksesimit në sistemin PERF:

8.1. Niveli i aksesimit në sistemin PERF përcaktohet në bazë të roleve të përdoruesve dhe kufizohet sipas funksioneve e kompetencave të tyre ligjore.

8.2. Aksesimi në sistem realizohet, si më poshtë vijon:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – akses i plotë administrativ dhe funksional për të gjitha të dhënat e sistemit;

b) Partitë politike dhe subjektet zgjedhore – akses për regjistrimin, përditësimin dhe konsultimin e të dhënave, që lidhen me subjektin përkatës;

c) Kandidatët e subjekteve zgjedhore dhe/ose ata të propozuar nga zgjedhësit – akses i kufizuar për deklarin dhe konsultimin e të dhënave, që lidhen me raportimin e tyre financiar;

ç) Financierët e partive politike – akses i kufizuar për deklarin dhe konfirmimin e kontributeve përkatëse;

d) Audituesit ligjorë – akses për shqyrtimin dhe verifikimin e të dhënave, në funksion të procesit të auditimit;

dh) Monitoruesit e fushatës zgjedhore – akses për regjistrimin e monitorimeve dhe konsultimin e të dhënave, që lidhen me raportimet e tyre.

8.3. Aksesimi realizohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe kufizohet vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e funksioneve ligjore të secilit rol.

9. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmerr masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, akses ose përhapje nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin apo përhapjen e të dhënave duhet të lërë gjurmë për qëllime sigurie dhe auditimi.

10. Ngarkohen Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama